URDHËR
Nr. 373/2, datë 11.10.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, germat "d", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3926, datë 22.9.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1, të urdhrit, togfjalëshi "deri më datë 12.10.2021" zëvendësohet me togfjalëshin "deri më datë 26.10.2021".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu